



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E INTEGRITETIT, MBIKËQYRJES DHE ANKESAVE ADMINISTRATIVE E
GJYQËSORE

Lënda: Kthim përgjigje tuajës të datës 15.03.2022

ZNJ. ORNELA MARKU

Tiranë

Për dijeni:

INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE
Kryeinspektorit Eljo Muçaj

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj të datës 15.03.2022, protokolluar me tonën nr. 1944 prot., datë 23.03.2022, përmes së cilës kërkoni informacion, bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije se:

Për sa i përket kërkesës tuaj, në lidhje me informacionin e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH), për lirim tuaj nga shërbimi civil, ju bëjmë me dije se, dokumentacioni përkatës është përcjellë me shkresën e datës 2637 prot., datë 03.12.2021, protokolluar me tonën nr. 6658, datë 06.12.2021, ku njoftohemi për vendimin e lirit nga shërbimi civil, për nëpunësen znj. Ornela Marku. Bashkëngjitur do të gjeni një kopje të dokumentacionit.

Në lidhje me kërkesën tuaj, për njoftimin e Departamentit të Administratës Publike, mbi masën disiplinore “Vërejtje”, ndaj nëpunësit civil z. Gj. Ç., pas komunikimit me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, me shkresën nr. 659 Prot, datë 28.03.2022, protokolluar me tonën nr. 2131 Prot., datë 30.03.2022, jemi vënë në dijeni se, me Vendimin nr. 128, datë 14.06.2021, është marrë masa disiplinore “Vërejtje”, ndaj z. Gj. Ç.

Në përgjigje të këtij njoftimi, bazuar në nenin 20, të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në Administratën Publike”, Departamenti i Administratës Publike i ka sjellë në vëmendje ISHPSHSH-së detyrimin për përcjelljen e masave disiplinore pranë DAP, brenda 10 ditëve nga marrja e këtyre masave, me qëllim regjistrimin e tyre.

Faleminderit për mirëkuptimin.